



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.82

Prishtinë, më 20.3.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Ismajl Kurteshi, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi, Bekim Haxhiu dhe Mufera Shinik.

Mungoi: Sërgjan Popoviq.

Përfaqësues të ftuar: Ismet Rexhepi (FASK), Mehmet Bogujevci (BOKS), Astrit Haliti (FNK), Latif Demolli (FBOXK), Genc Fazlija (FM), Agim Gashi (FFK) dhe Arianit Ahmeti (FFK).

Përfaqësues të tjerë: KDI dhe Media.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shaip Goxhuli dhe Granit Brajshori - praktikant.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 20.2.2017 dhe 22.2.2017;
3. Diskutim lidhur me sponsorizimet në fushën e sportit;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 20.2.2017 dhe 22.2.2017

Anëtarët e Komisionit miratuan pa vërejtje procesverbalet e dy mbledhjeve të kaluara.

3. Diskutim lidhur me sponsorizimet në fushën e sportit

Nait Hasani e hapi takimin e Komisionit duke i njoftuar të pranishmit për interesimin e shprehur nga përfaqësuesit e Federatave sportive për të diskutuar lidhur me zbatimin e Ligjit për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Hasani tha se në këtë takim kanë qenë të ftuar të gjitha federatat sportive, përfaqësues të Ministrisë e ATK-së, si dhe përfaqësues të tjerë të fushës në fjalë. Ai tha se Komisioni gjatë fazës së shqyrtimit dhe amendamentimit ka marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet nga palët e interesit, por që tani në zbatueshmeri kanë dalë pengesa me Ligjin për Korporatat. Hasani shtoi se Komisioni e ka bërë punën e vet duke e proceduar dhe miratuar në Kuvend dhe se tani iu mbetet Federatave të bëjnë presion te ministrinë e linjës për të zbatuar atë. Ai më tutje shtoi se Federatat duhet të kërkojnë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të kërkojë nga Ministria e Financave që të sjellë për plotësim ndryshim ligjin për Korporatat dhe të ndryshohet pjesa për tatimin mbi vlerën e shtuar sa i përket çështjes së sponsorizimeve në sport.

Ismet Rexhepi, përfaqësuesi i Federatës së Autosportit, foli për keqkuptimet me të cilat janë ballafaquar gjatë takimeve që ata kanë realizuar me përfaqësuesit e ATK-së, në lidhje me tatimin në fitim. Sipas tij, atyre u është thënë se të gjitha organizatat që janë OJQ nuk kanë të drejtë të shesin produktet e tyre. Ai kërkoi të sqarohet çështja se pse Federatat nuk kanë të drejtë të shesin reklama dhe shprehi shqetësimin e tij duke thënë se me 20% investime në sport nuk mund të ngritët cilësinë dhe të zhvillojmë sportin në vend. Ai vuri në pikëpyetje fuqinë që Federatat mund të kenë për të shtyrë përpara zbatimin e Ligjit për sponsorizime duke thënë se ministria është ajo që duhet të garantojë zbatimin e këtij ligji.

Latif Demolli, përfaqësues nga Federata e Boksit, tha se është mirë të kemi një **shabllon** të Ligjit për sponsorizime që kur të kërkojmë sponsorizime, t'ua prezantojmë edhe donatorëve apo sponsorizuesve potencial në mënyrë që të kemi bazë për kërkesat tona.

Agim Gashi, përfaqësues nga Federata e Futbollit, tha se ky diskutim është i pakompletuar si përbërje sepse po mungojnë përfaqësuesit e MKRS, MF dhe të ATK. Ai tha se nuk e sheh të arsyeshme të bëhet presion te ministrinë përkatëse për zbatimin e Ligjit për sponsorizime pasi që një ligj i tillë është i obligueshëm për t'u zbatuar në momentin që hyn në fuqi pas miratimit të tij në Kuvend. Presim nga MKRS që të dalë shpejt më një rregullore dhe propozim forme se si të vihet deri të sponsorizimi. Sipas tij, qëllimi i ATK është që të fus në një farë lloje Federatat për të bërë shitje mbi vlerën e 30 mijë eurove dhe në atë mënyrë t'i tatimojnë ato. Ai shtoi se ky

Ligj duhet të fillojë së zbatuari sa më shpejt që është e mundur për t'i ndihmuar çështjes së sportit në përgjithësi.

Bekim Haxhiu tha se ky Ligj është produkt i një pune intensive dhe të vështirë por në hartimin e së cilit nuk ka pas një pjesëmarrje të kënaqshme të aktorëve për të dhënë kontributin e tyre. Ai theksoi se ky Ligj tani është në fuqi dhe shtoi se arsyeja pse jemi takuar sot është se institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji kanë hasur në vështirësi. Haxhiu tha se Ministria e Financave po i bën presion ATK-së për moszbatimin e këtij ligji duke kërkuar që edhe më tej të respektoj Ligjin për tatimin në korporata. Haxhiu theksoi se Federatat kanë të drejtë të kërkojnë përgjegjësi penale në rast të moszbatimit të Ligjit për sponsorizime, sepse, sipas tij, ky ligj i prek drejtpërdrejt ata në zhvillimin e funksionimit të mirëfillt të tyre. Ai i sigurojë përfaqësuesit e federatave që Komisioni për Kulturë, Rini dhe Sport është e përkushtuar për monitorimi i zbatimit të Ligjit në fjalë. Haxhiu tha se ky është versioni më i mirë i Ligjit që rregullon këtë fushë për zhvillimin e sportit.

Salih Morina tha se Komisioni e ka kryer punën e vet dhe se ka pasur mjaft vështirësi deri tek arritja e kësaj përmbajtje të Ligjit, pasi që përfaqësuesit e Ministrisë së Financave kanë thënë së një përqindje e tillë është e papërbalueshme për Qeverinë e Kosovës, kur kemi fjalën për zbatimin e tij në praktikë. Ai tha se do të ishte mirë që Komiteti Olimpik, si përfaqësues i të gjitha Federatave, të kërkojnë përgjegjësi tek institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit për sponsorizime, pasi që vendimet dhe ligjet që nxjerr Kuvendi i Republikës janë të obligueshme dhe duhet respektuar. Ai u bëri thirrje përfaqësuesve të Federatave që të jenë shumë më aktiv në kërkesat e tyre karshi institucioneve implementuese.

Teuta Haxhiu tha se është e zhgënjyer për moszbatimin e këtij ligji dhe se ka pritur që të njoftohet nga përfaqësuesit e Federatave për kundërshtimet që ka ligji për sponsorizime me ndonjë ligj tjetër dhe në këtë mënyrë të ndërhyjnë dhe ta përmirësonin atë. Ajo shtoi se ligji duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet dhe se si Komision do të kryej punën e vet të monitorimit të zbatimit, por që iu duhet kohë që të shohin zbatimin e tij. Haxhiu tha se nuk mund të paragjykojmë se si do të jenë aktet nënligjore që do t'i nxjerrë Ministria për ligjin në fjalë dhe se ajo ka dhënë votën e saj për këtë ligj duke shprehur që t'i ndihmojë sportit në përgjithësi.

Shukrije Bytyçi tha se gjendja në sport nuk është e mirë. Ajo tha se fatmirësisht, ambasadorët më të mirë të Republikës janë sportistët tanë dhe shprehu pajtimin me konstatimin e përfaqësuesit të FASK që kërkesat e Federatave nuk po përfillen nga Ministria dhe se kjo pastaj po sjell vështirësi në realizimin e projekteve që do të ndikonin në avancimin e sportit. Bytyçi tha se është për t'u shqetësuar infrastruktura sportive, gjendja e së cilave vazhdon të jetë jo e mirë. Ne e kemi parë të udhës që të hartojmë një Ligj për sponsorizime edhe pas kërkesave të shumta të Federatave pasi që ka shumë njerëz të vullnetit të mirë që duan ta ndihmojnë sportin. Ajo shtoi se në momentin që vlerësohet që është i nevojshëm monitorimi i këtij Ligji, Komisioni do ta bëjë një gjë të tillë dhe theksoi se Ministrinë e linjës përkatëse janë të obliguara të zbatojnë ligjin e miratuar në Kuvend.

Ismajl Kurteshi tha se asnjë vërejtje nuk u paraqit nga përfaqësuesit e Federatave sa i përket ndonjë neni apo edhe vetë Ligjit për sponsorizime. Ai theksoi se Ligji është në fuqi dhe si i tillë duhet të zbatohet dhe se në rast se një gjë e tillë nuk bëhet, pastaj janë gjykatat ato që do të duhej të merreshin me të. Kurteshi shtoi se duke mos dashur të heq përgjegjësinë që ka Komisioni, ai vlerësoi se janë të pafuqishëm për të ndikuar dhe bërë presion tek institucionet relevante për të respektuar ligjin. Ai theksoi se për Ligjin për sponsorizime duhet pritur edhe pak deri sa të hartohen dhe të hyjnë në fuqi aktet nënligjore dhe më pastaj mund ta vlerësojmë punën e bërë.

Mufera Shinik vlerësoj se është bërë punë e madhe për Ligjin për sponsorizime dhe se të gjitha propozimet e përfaqësuesve të Federatave janë marrë parasysh, por ajo theksoi që në rast se ka nevojë për ndonjë ndryshim eventual të ligjit, atëherë kjo mund të bëhet me leximin e tretë të tij, por që paraprakisht duhet t'i kemi vërejtjet dhe sugjerimet e federatave.

Ndërkohë, në këtë pikë, Nait Hasani shtoi se një lexim i tretë bëhet në rast se Ligji nuk kalon te Presidenti, por që për këtë ligj, ky proces është mbyllur dhe ligji është në fuqi.

Shpejtim Bulliqi tha se do të ishte dashtë që të kemi propozime dhe vërejtje konkrete nga Federatat dhe shtoi se të gjitha institucionet janë të obliguara t'i zbatojnë ligjet që nxjerr Kuvendi. Ai shtoi se duhet pritur edhe pak kohë deri sa ligji të fillojë të zbatohet pas nxjerrjes së akteve nënligjore dhe më pastaj do të mund të vlerësonim dhe shihnim se si do të mund t'i zgjidhnim të metat eventuale. Ai tha se Federatat duhet të jenë të harmonizuara në qëndrimet dhe kërkesat e tyre në rast të ndonjë vërejtjeje apo propozimi.

Mehmet Bogujevci, nga Federata e Boksit, theksoi se vlerëson shumë punën e Komisionit duke e konsideruar si mundësi të mirë për zhvillimin e sportit, por që kërkojë që aktet nënligjore të hartohen sa më shpejtë dhe ligji të zbatohet.

Arianit Ahmeti, Federata e Futbollit, tha se nga ky takim ka pritur të njoftohen nga anëtarët e Komisionit për hapat që duhet të ndërmerren për zbatimin e ligjit dhe për këtë ai u njoftua nga anëtarët e komisionit se një gjë e tillë është e rregulluar me nene të veçanta në ligj.

4. Të ndryshme

Nait Hasani i njoftoi anëtarët e Komisionit, se janë ftuar nga drejtuesit e kolegjit Mehmet Akif për të realizuar një vizitë në këtë institucion për të parë më afër procesin edukativo- arsimor.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që këtë vizitë ta realizojnë ditën e hënën, më 27 mars.

Teuta Haxhiu i njoftoi anëtarët e Komisionit për iniciativën e saj për debat parlamentar, ku do të diskutohej 'Siguria në shkollë', të cilën e konsiderojë si jo të mirë dhe dukuri mjaft shqetësuese.

Ismajl Kurteshi pati vërejtje për moszbatimin e planit të punës së Komisionit, plan ky i miratuar në fillim të vitit, si dhe kërkoi që dëgjimet publike për Inspektoratin duhet të vazhdojnë. Po

ashtu, ai ngriti shqetësimin e mos kompensimit të pagës jubilarë me rastin e pensionimit të mësimdhënësve.

Shpejtim Bulliqi propozoi që në një të një nga mbledhjen e radhës së Komisionit të ftohen përfaqësuesit e MASHT, për të na njoftuar lidhur me çështjen e mësimdhënësve të viteve '90 -ta, për të cilën tha se MASHT ka pasur për obligim të hartojë projektligjin për njohjen e stazhit të punës.

Nait Hasani njoftoi anëtarët e komisionit që vizita e paraparë në Slloveni është anuluar për arsye të mos koordinimit të datave për realizimin e takimeve me institucionet që Komisioni ka vlerësuar që janë më interes për t'u vizituar.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani